

VENDIM
Nr. 116, datë 8.7.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQATËS SHQIPTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME
PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 101, DATË 23.6.2016 TË BORDIT TË ERE-s, “MBI
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË MODELIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SHA (FPSH) DHE PRODHUESVE TË
VEGJËL TË ENERGJISË (PVE) MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 80, DATË 23.10.2009, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 16, pika 4, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsuma-torit, mbi kërkesën e Shoqatës Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme, AREA, për rishikimin e vendimit nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Shoqata AREA nuk përfaqëson palë interesi, të legjitimuar për të kërkuar rishikimin e një vendimi, akt normativ, të Bordit të ERE-s.

- Nuk është provuar se cilat janë subjektet e licencuara nga ERE, interesat e të cilave prezumohet se janë cenuar nga vendimmarrja e ERE-s.

- Nuk është paraqitur asnjë provë për të mbështetur kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar”.

- ERE ka detyrimin të të zbatojë parashikimet e legjislacionit në fuqi, përfshirë ligjin 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjin 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme” dhe VKM-së 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e Shoqatës Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme, AREA, për rishikimin e vendimit nr. 101, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të ndryshuar”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsu-matorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

